

Komisioni për rihapjen e çështjeve penale

Informacion për të dëmtuarin dhe të afërmit e lënë pas

Pozita e të dëmtuarit në kërkesën për rihapjen e një çështjeje penale

Kur një i gjykuar bën kërkesë për rihapjen e një çështjeje, i është dhënë avantazh si të dëmtuarit po ashtu të afërme të lënë pas (sic iu njihet ligjërisht), kjo sipas legjislacionit mbi procedurën e gjyqit në çështjet penale. Kjo do të thotë që i dëmtuari ose të afërmit e lënë pas duhet ti jepen informacionet dhe mundësi e njohjes me përmbajtjen e dokumentave, po ashtu edhe mundësi për të dhënë një deklaratë lidhur me çështjen.

Kur bëhet fjala për çështje serioze atëherë komisioni mundet të emërojë për të dëmtuarin ose të afërmit e lënë pas një avokat të posaçëm (krime seksuale, thyerje e ndalimit të kontaktit, ndalim vizitash) nqse kjo gjë është e dëshirueshme.

Edhe pse i dëmtuari/të afërmit e lënë pas nuk dëshirojnë të përdorin të drejtat që i takojnë sipas ligjit, atëherë ka të ngjarë që komisioni të kontaktojë të dëmtuarin/të afërmit e lënë pas, për shembull për të përfunduar marrjen në pyetje të dëshmitarëve.

Vlerësim objektiv

Komisioni i rihapjes është një organ i përbërë i gjerë i pamvarur. Pas marrjes së një vlerësimi objektiv, komisioni, duhet të vendosë nëse kushtet për rihapjen e çështjes plotësohen. Komisioni vendos vetë mënyrën e punës dhe nuk mund të intsrucktohet (udhëzohet).

Kushtet për rihapje

Arsyet më të rëndësishme që një gjykim me vendim të prerë të një çështjeje penale të rishqyrtohet ne gjyq, janë:

- Prova ose rrethana të reja që mund të çojnë deri në lirim ose në dhënjën e një dënimi substancialisht (shumë) më të ulët.
- Nëse një gjykatë ndërkombëtare ka konstatuar që vendimi ose shqyrtimi i çështjes bie në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut, me rrjedhojë që një rishqyrtim i mundshëm i çështjes rezulton në një vendim tjetër nga ai ekzistues.
- Në rast se dikush që ka pasur të bëjë në një mënyrë të drejtpërdrejtë me çështjen në fjalë, ka pranuar fajin duke mos qenë fajtor në një vepër penale që mund të ketë pasur domethënie (rëndësi) në marrjen e vendimit.

-Kur ka raste të veçanta që paraqesin dyshime nëse gjykimi është i drejtë, arsye të rëndësishme kërkojnë që çështja të hapet përsëri.

Analizim i plotë

Komisioni i rihapjes ka përgjegjësi që të ndërmerret një analizim i plotë gjyqësor si edhe shqyrtim i anës faktike të çështjes, si dhe mund të marrë informacione në atë mënyrë që mund të konsiderohet e përshtatshme. Komisioni mund të thërrasë të gjykuar dhe dëshmitarë, duke përfshirë edhe të dëmtuarit, për të marrë në pyetje, mund të japë urdhër për ekstradim dhe të emërojë ekspertët(kompetentët). Komisioni ka një sekretariat të vetin me analizues që ndihmojnë në shqyrtimin e çështjeve. Kryetari i komisionit mundet ti refuzojë kërkesat që sipas mendimit të tij nuk mund të rihapen, si dhe, kërkesat që duken haptazi që janë pa arsye. Për çështje të tjeravendos komisioni.

Të drejtat e të dëmtuarit

Nqse kërkesa i nënshtrohet shqyrtimit, atëherë duhet që i dëmtuari/të afërmit e lënë pas të informohen që kërkesa u pranua.

Si i dëmtuar/i afërm i lënë pas ju keni:

- Si rregull, të drejtën e njohje se përmbajtjes së dokumentave të çështjes penale.
- Të drejtë për të dhënë një deklaratë me shkrim në lidhje me kërkesën
- Të drejtë për ti dhënë komisionit shpjegim
- Si rregull të drejtën për shikimin e informacioneve të mbledhura nga komisioni
- Të drejtë për të dhënë deklaratë që ka të bëjë me materialin e mbledhur.
- Të drejtë për të qenë i informuar mbi rezultatit/përfundimin e shqyrtimit të çështjes nga komisioni.

Komisioni për rihapjen e çështjeve penale

Informacion për të dëmtuarin dhe të afërmit e lënë pas

<p>Komisioni i rihapjes Komisioni për rihapjen e çështjeve është një organ i pamvarur, që vendos nëse një dënim nga një gjykim me vendim te prerë (pa të drejtë ankese) duhet të rishqyrtohet apo jo. Nëse vendoset që çështja të rihapet, atëherë duhet që çështja e fajësisë (nëse fajtor apo jo) dhe/ose caktimi i dënimit të rishqyrtohet në një gjykatë tjetër dhe jo në atë që u shpall dënimi.</p> <p>Anëtarët e komisionit të rihapjes së çështjeve penale</p> <p>Antarët e komisionit emërohen nga Mbreti në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, komisioni ka pesë antarë dhe tre zv. antarë. Kryetari, zv. kryetari dhe një nga antarët duhet te kenë Gradë Akademike ne Shkencat Juridike.</p>	<p>Kryetari emërohet për një periudhë 7-vjecare pa mundësi për zgjatje. Antarët emërohen për një periudhë 3-vjecare, me vetëm një mundësi për riemërim.</p> <p>Anëtarët kanë së bashku shumë përvojë në fushat e mëposhtme si :gjykata, organet e ndjekjes penale, organet e mbrojtjes, shkenca dhe jeta shoqerore etj..</p> <p>Analistët e komisionit Përveç kryetarit, komisioni ka një sekretariat me dhjetë punonjës, ku tetë nga këto janë analistë dhe dy janë nëpunës. Gjashtë prej analistëve janë juristë dhe dy kanë përvojë ose shkollim nga policia.</p>
--	---

Dispozita aktuale në ligjin mbi procedurën e kodit penal

§ 397 neni pesë

Komisioni informon për sa i përket kërkesës, të dëmtuarin dhe të afërmit sipas rradhës të rregulluar me ligj, me përjashtim kur ajo rrefuzohet sipas nenit të tretë. I dëmtuari dhe të afërmit e lënë pas duhet të informohen sipas rradhës të rregulluar me ligj (afërsia familjare) rreth të drejtës për njohjen e përmbajtjes së dokumentave, të japin deklaratat dhe të bëjnë kërkesë për ti dhënë shpjegim komisionit, përfshirë këtu edhe mundësinë për t'iu caktuar avokat te posacëm.

§ 398 neni dy

I dëmtuari dhe të afërmit e lënë pas, sipas rradhës të rregulluar me ligj (afërsia familjare), duhet ti jepet rasti për të dhënë deklaratë me shkrim për sa i përket kërkesës. I dëmtuari dhe të afërmit e lënë pas mund të bëjnë lutje për ti dhënë shpjegime komisionit në bazë të dispozitave në § 398 a.

Adresa dhe nr. e telefonit

Adresa postare: Postboks 2097 Vika, 0125 Oslo
Adresa e vizitave: Tordenskioldsgate 6
Telefon: 22 40 44 00
Faks: 22 40 44 01
Email: post@gjenopptakelse.no
Faqja ne internet: www.gjenopptakelse.no

Nqse ju keni pyetje persa i perket kushtet per rihapjen dhe/ose per shqyrtimin e ceshtjes , ju lutemi kontaktoni me komisionin.